

# STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "ARB-ANT UNION NET KUCOVA 2024 " shpk

Në këtë statut

"Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008"PërTregtarëdhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;  
"Statuti"ështëStatuti i shoqërisë;

Kreul

**Themelimi,Emri,Objekti,Kohëzgjatja,Selia**

## **Neni1:Data e Themelimit,EmridheThemeluesit**

Sot,më 24. 10. 2024, me cilësinë e themeluesit, kam krijuar shoqërinë me përgjegjësi tëkufizuar,me emrin "ARB-ANT UNION NET KUCOVA 2024" shpk  
Themeluesi i shoqërisë wshtw Z. Anteo Karakashi , e indentifikuar me ID(nr.personal) J80712078E, lindur ne Kucove dhe banuese në Kucovw; me adrese Lagjia "Tafil Skendo";  
Nd.:048 ; H.0 ;Ap.0

## **Neni 2: Objekti**

**Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:**

Trasferta dhe pagesa per emer dhe llogari te institucionit financiar jo bankar , AK-invest sh.a , Kembim valutor , Agjensi turistike dhe biletari ,Agjensi Imobilare,çdo operacion financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj, brenda parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e papërcaktuar.

## **Neni 4:Selia**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: ,Bashkia Kucove , Lagjia "Tafil Skendo" Rruga Stanislav Zyber, Nr. pasurie 12/378, volumi 41 , faqe 102 Godine 3KT Hyrja255, Zona kadastrale 2310 prane Terminalit Kucove

(2)Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është do te hapet me krijimin e shoqerise.

(3)Adresa e shoqërisë,për qëllime komunikimi elektronikë shtë:

anteokarakashi1998@hotmail.com

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5:Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i regjistruar i shoqërisë, është 2,500,000( Dymilion e peseqind mije ) lekë e Cila perfaqeson Njw(1) kuote

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e regjistruar të shoqërisë është në përputhje me kontributin, si më poshte:Ortaku themelues eshtw Anteo Karakashi , zoteruesi 1

(një)kuote,me vlerë të përgjithshme 2,500,000(Dymilion e peseqind mije ) lekë, tëkapitalit

themeltar të shoqërisë

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të depozitohet në llogarite bankare të shoqërisë me marrjen e statusit juridik.

#### **Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëvetë kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëvetë kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7: Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar etë drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit në kapitalin e shoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit;

çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

### **ORGANET VENDIM MARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8: Organi Vendim marres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendim marresi i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja epërgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështje të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e ilikuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- f) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblet e ortakëve të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë në sipërfaqësues i ortakëve në asamblet e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9: Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'udërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10: Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmë në numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11: Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërta të votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-se për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 12: Përfshirja nga e drejta e votës**

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13: Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorë të një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Administratori i shoqërisë është Z. Anteo Karakashi, e indentifikuar me ID(nr.personal) J80712078E, lindur në Kucovë dhe banuese në Kucovë me adresë Lagjia "Tafil Skendo"; Nd.:048 ; H.0 ; Ap.0, me afat emerimi 5 vjet dhe me të drejtë riemerimi.

### **Neni 14: Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktive të shoqërisë nuk i mbulojnë detyrime të kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkëri sht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënies kontraktore meshoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15: Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që isjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
2. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
3. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

4. të parandalojë dhe mënjanëjë rastete konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
5. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
6. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
7. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1e2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të
8. vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
9. Në Mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet të shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprime të mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d)
  - e) ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - f) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që ingarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose sebashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabime të kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

#### **Viti financiar-ekspertet**

#### **Neni 16: Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### **Neni 7: Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të

ushtruara prej tij pe rrasitet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille ingarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabe i autorizuar pergatit raportin me shkrim pe nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte idetyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **Kreu V**

### **Prishja–riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni18: Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohë zgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723,datë3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyre ne likuidimit te shoqerise, duke caktua 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqerine likuidime siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesite emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo personi i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet ,bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesës së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”, i ndryshuar.

#### **Neni 20: Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodin Civil dhe çfarë do ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 21: Mosmarrëveshjet**

Per mos marreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti ,si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve ,do teje te kompetente Gjykata Shqiptar.

**Kucove me 24 Tetor 2024**

***ORTAKET THEMELUES***  
***TE SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TËKUFIZUAR***  
**ARB-ANT UNION NET KUCOVA 2024**

**ANTEO KARAKASHI**